

EES...

Sistemi i regjistrimit të hyrje-daljeve (EES)

Sistemi i automatizuar me vetëshërbim

..... ofron

- regjistrim automatik të shtetasve nga vende joanëtare në BE sa herë që kalojnë një pikëkalimi të kufijve të jashtëm të zonës Shengen
- reduktim gradual të kohës së pritjes te kontrolli i pasaportave
- thjeshtim dhe automatizim të procedurave në kufi

...zbatohet* për

- Shtetasit nga vende joanëtare të BE-së që udhëtojnë për qëndrim të shkurtër, deri në 90 ditë brenda 180 ditëve.
- personat të cilët kanë detyrimin të pajisen me vizë për të udhëtuar
- personat të cilët përjashtohen nga detyrimi për t'u pajisur me vizë

...mbledh të dhëna** për

- emrin, datën e lindjes, shtetësinë, gjininë
- dokumentin e udhëtimit
- imazhin e fytyrës dhe/ose gjurmët e gishtave

...regjistron**

- datën dhe vendin e hyrjes dhe daljes nga një shtet evropian që përdor EES-në
- refuzimet e hyrjes, nëse ndodh

Sistemi i
Hyrje-
Daljeve

*zbatohen disa përjashtime

** Mbledhja dhe regjistrimi i të dhënave do të fillojë gradualisht në pikëkalimet kufitare nga data 12 tetor 2025, dhe zbatimi i plotë do të jetë brenda 10 prill 2026.

1

Sipas rastit, udhëtarët me pasaportë biometrike mund t'i paraqesin dokumentet e udhëtimit në sistemet e vetëshërbimit. Punonjësit e policisë së kufirit do të ndihmojnë dhe/ose do të mbikëqyrin procesin.

2

Udhëtari duhet që të paraqesë dokumentet si dhe të japë të dhënat biometrike (imazhin e fytyrës dhe gjurmët e gishtave) në sistemin e vetëshërbimit

3

Punonjësi i policisë verifikon informacionin e marrë nga sistemi i vetëshërbimit, bën pyetje sipas rastit, autorizon ose refuzon hyrjen e udhëtarit, dhe i regjistron në sistem

4

Udhëtari përfiton nga një proces më i lehtë dhe më i efektshëm për kalimin e kufirit



#TravelToEurope

Skano kodin QR për më shumë informacion ►

